



eptisa

PROJECT IMPLEMENTED BY JV NTU/EPTISA



FINANCED BY GOA AND COFINANCED BY WB



WORLD BANK GROUP

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Projekti i Sigurisë dhe Mirëmbajtjes Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP)

Hua e Bankës Botërore Nr. 8489-AL

Nr. i kontratës: CS 02

Shërbime Konsulence

për


Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore

Trajnim gjatë punës për zbatimin e fushatës së publicitetit dhe ndërgjegjësimit

D-4.6 Shtojca 2

Versioni Paraprak

Prill 2021



TË DHËNAT E IDENTIFIKIMIT TË PROJEKTIT

Emri i Projektit:	Shërbim Konsulence për Asistencë Teknike të Sigurisë Rrugore—Projekti i Sigurisë dhe Mirëmbajtjes Rrugore bazuar në rezultate. (RRMSP)
Kontrata e projektit Numri i Referencës:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL
Shteti:	Shqipëri
Konsulent:	JV NTU InternationalA/S / EPTISA Servicios De Ingenieria S.L.
Adresa:	Vestre Havnepromenade 5, 4. Floor DK-9000 Aalborg Denmark
Telefon:	+45 99 30 0000
Faks:	+45 99 30 0001
Personi i Kontaktit:	Dritan Dibra –Menaxher i Projektit, Eptisa
E-mail:	ddibra@eptisa.com
Data e Raportit:	Prill 2021
Autorët e raportit:	Gela Kvashilava, K-8 Specialist komunikimi lonelaSufaru, K-9 Specialist për Survejim në Komunitet <i>Me shqyrtim nga: Stelios Efsthadiadis, K-1 Specialist për Menaxhimin e Sigurisë Rrugore -Lideri i ekipit</i>

SQARIM

Ky raport (duke përfshirë çdo shtojcë dhe dokument të bashkëlidhur) është përgatitur për përdorim ekskluziv dhe përfitim të Qeverisë së Shqipërisë/ Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Bankës Botërore dhe vetëm për qëllimin për të cilin është përgatitur. Asnjë pjesë e këtij raporti nuk duhet të riprodhohet, shpërndahet apo t'i komunikohet një palë të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të JVNTU/EPTISA. JVNTU/ EPTISA nuk pranon asnjë përgjegjësi nëse ky raport përdoret për qëllim tjetër nga ai për të cilin është menduar, as nga ndonjë palë të tretë në lidhje me këtë raport.

KONTROLI I DOKUMENTIT

Kontrata e projektit Numri i Referencës:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL Shërbim Konsulence për Asistencë Teknike të Sigurisë Rrugore – Projekti i Sigurisë dhe Mirëmbajtjes Rrugore bazuar në rezultate (RRMSP)
Shteti	Shqipëri
Datë	30.04.2021
Versioni	N°01

Versioni	Datë	I përgatitur nga	Shqyrtuar nga
N°01	30.04.2021	Gela Kvashilava	Dragan Kostadinov Drejtore i Projektit

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky dokument përbën Shtojcën 2 të rezultatit të 4.6 "Raporti i Përkohshëm i Progresit nr. 6" të Komponentit 4 të Asistencës Teknike të Sigurisë Rrugore (AT) nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të Bazuar në Rezultate (RRSMP).

Komponenti 4 përfshin katër aktivitete kryesore të cilat, secila nga ato, përfshijnë nën-aktivitete të ndryshme – Përgatitjen e fushatave vjetore të publicitetit dhe ndërgjegjësimit për të mbështetur IMRSC duke përfshirë programet e forcimit të policisë së trafikut që kanë si objektiv sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezik të lartë; Trajnimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ARA, personelin e policisë së trafikut dhe autoritete të tjera qeveritare ose OJQ-të në hartimin dhe zbatimin e fushatave vjetore të publicitetit dhe ndërgjegjësimit në korridoret dhe zonat me rrezik të lartë; Vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të fushatave të publicitetit dhe ndërgjegjësimit; Përgatitjen e një fushate (kombëtare) për publicitet dhe ndërgjegjësim pas projektit dhe udhëzime për të mbështetur programet e forcimit të policisë së trafikut që kanë si objektiv sjelljet e pasigurta në të gjithë rrjetin.

Përmirësimi i sjelljes së përdoruesve të rrugës është thelbësor për zvogëlimin e fataliteteve dhe lëndimeve të trafikut rrugor. Në Shqipëri, sjellja e përdoruesve të rrugës mund të përmirësohet nga fushatat e sigurisë rrugore, të cilat në kombinim me forcat e ligjit, edukimin dhe trajnimin mund të bëhen një mjet i fuqishëm. Zbatimi i masave efektive të sigurisë rrugore në terren kërkon një shkallë të caktuar të njohurive nga ana e personave në vijë të parë të punës dhe një gatishmëri për të qenë proaktiv dhe për të bashkëpunuar me agjencitë e tjera.

Prandaj, ne duhet të sigurojmë që të gjithë palët e interesuara në rrugë, përfshirë përfaqësuesit e qeverisë qendrore dhe lokale të kenë njohuritë dhe aftësitë e duhura për të qenë në gjendje që të kryejnë punën e tyre dhe të bashkëpunojnë në mënyrë efektive kur ata kryejnë fushata të publicitetit dhe rritjes së ndërgjegjësimit. Është thelbësore që qeveria dhe drejtuesit e agjencive kryesore të jenë të angazhuar për sigurinë rrugore, por përkthimi i këtij angazhimi në realitet kërkon njohurinë dhe angazhimin e zyrtarëve deri në hallkat më poshtë.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje	9
2. Objektivat e veprimtarisë dhe detyrave	9
3. Metodologjia e trajnimit.....	10
4. Kryerja e sondazheve për të identifikuar sjelljet me rrezik të lartë të përdoruesve të rrugëve dhe vlerësimi i efikasitetit të fushatës së ndërgjegjësimit.....	11
5. Hartimi i Fushatës së Publicitetit dhe Ndërgjegjësimit për Sigurinë Rrugore	12
6. Praktikant më të mira nga vendet e tjera rreth fushatëve të publicitetit dhe ndërgjegjësimit	13
Aneks A Diapozitivat e trajnimit.....	14

LISTA E FIGURAVE

<i>Figura 1. Proceset e ndërtimit të kapaciteteve.....</i>	10
--	----

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AADT	Mesatarja Vjetore e Trafikut Ditor
ADF	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
ANPR	Njohja e Automatizuar e Numrave të Targave
ARA	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ARC	Kodi Rrugor Shqiptar
ARDCS	Standardet Shqiptare të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve
ARDM	Manuali i Projektimit të Rrugëve Shqiptare
ASP	Policia e Shtetit Shqiptar
ATC	Numërimet Automatike të Trafikut
ATP	Policia Rrugore Shqiptare
BSM	Menaxhimi i Vendngjarjeve
CBMIE	Organi Kontrollues në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
CSG	Grupi Drejtues Qendror
DRST	Drejtoria e Sigurisë Rrugore dhe Trafikut
EC	Komisioni Evropian
EG	Grupi i Ekspertëve në nivel lokal
ERA	Reagimi i Emergjencave në Shqipëri
EU	Bashkimi Evropian
GDRTS	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
GoA	Qeveria e Shqipërisë
GRD	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
IMRSC	Komiteti Ndërmintor i Sigurisë Rrugore
INSTAT	Instituti i Statistikave
IoT	Instituti i Transporteve
IPA	Instrumenti për Ndhimë Para Anëtarësimit
iRAP	Programi Ndërkombëtar i Vlerësimit të Rrugëve
ITS	Sistemi inteligjent i trafikut
JV	Joint Venture
M&E	Monitorimi dhe Vlerësimi
MI	Ministria e Brendshme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NGO	Organizatat joqeveritare
NSM	Menaxhimi i Sigurisë së Rrjetit
PAMECA	Misioni i Asistencës Policore i Komunitetit Evropian në Shqipëri
PIARC	Shoqata Botërore e Rrugëve
QKUM	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
RRMSP	Projekti i Sigurisë dhe Mirëmbajtjes Rrugore bazuar në rezultate
RSA	Auditimi i Sigurisë Rrugore
RSAIU	Njësia e Auditimit dhe Inspektimit të Sigurisë Rrugore
RSI	Inspektimi i Sigurisë Rrugore
RSIA	Vlerësimi i Ndikimit të Sigurisë Rrugore
RSM	Menaxhimi i Sigurisë Rrugore
RSS	Spektori i Sigurisë Rrugore
SEETO	Observatori i Transportit i Evropës Jug-Lindore

TA	Asistenca Teknike
TERN	Rrjeti Rrugor Trans Evropian
ToR	Termet e Referencës
TS	Sekretariati Teknik
WB	Banka Botërore
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë

1. Hyrje

Objektivat e Fushatave të Publicitetit dhe Ndërgjegjësimit që kanë si objektiv sjelljet e pasigurta janë si më poshtë:

- Mbështetje të paraqitjes dhe vlerësimit të fushatave të publicitetit dhe ndërgjegjësimit që mbështesin aktivitetet e IMRSC dhe programet e forcimit të policisë së trafikut që kanë si objektiv sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezik të lartë.
- Trajnim i MoIE (Zyra Qendrore), ARA dhe stafit të policisë së trafikut dhe organizatave të tjera qeveritare (Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Arsimit), si dhe konsulentë të asociuar kombëtarë (të cilët mund të përfshijnë përfaqësues të sektorëve privatë), gazetarë në fazën e zbatimit dhe menaxhimit të fushatave të publicitetit dhe ndërgjegjësimit që mbështesin programet e forcimit të policisë së trafikut që kanë si objektiv sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezik të lartë. Përfshirja e sektorit privat mund të rrisë përfitimin në qëndrueshmërinë pas projektit në mënyrën që sektori privat të mund të marrë pjesë në financimin e fushatave (d.m.th. kompanitë e sigurimeve, Automobile Club Albania, kompanitë e karburanteve, etj.).
- Përgatitje dhe këshillim (sigurimi i trajnimit në punë) në zbatimin e fushatave të synuara për përdoruesit e rrugës, duke mbuluar zhvillimin e strategjisë, krijimin e mesazheve, prodhimin e materialeve të fushatës dhe planifikimin dhe blerjen e hapsirave mediatike, me qëllim për të ndryshuar sjelljet destruktive të përdoruesve të rrugës duke ipërfshirë përmes veprimeve të cilat janë të pritshme.
- Vlerësimi efikasitetit dhe efektivitetit të fushatave të publicitetit dhe ndërgjegjësimit që mbështesin forcimin e policisë së trafikut duke shënjestruar sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezik të lartë.
- Mbështetje në përgatitjen e një fushate publiciteti dhe ndërgjegjësimi (kombëtare) pas projektit që mbështet programet e forcimit të policisë së trafikut që shënjestron sjelljet e pasigurta në të gjithë rrjetin, bazuar në përvojën e suksesshme në korridoret dhe zonat me rrezik të lartë.

Ky raport synon të përshkruajë trajnimet e kryera për stafin e MoIE, ARA dhe policisë së trafikut, dhe organizatave të tjera qeveritare, si dhe këshilltarëve të asociuar kombëtarë, gazetarëve për zbatimin dhe menaxhimin e fushatave të publicitetit dhe ndërgjegjësimit që mbështesin programet e forcimit të policisë së trafikut që vë nën shënjestër sjelljet e pasigurta korridoret dhe zonat e rrezikut.

2. Objektivat e veprimtarisë dhe detyrave

Objekivi kryesor i Aktivitetit 4.2 ishte trainimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ARA, personelit të policisë së trafikut dhe autoriteteve të tjera qeveritare (Shëndetësia, Arsimit, etj.) ose OJQ-ve në hartimin dhe zbatimin e fushatave vjetore të publicitetit dhe ndërgjegjësimit korridoret dhe zonat e rrezikut. Figura më poshtë paraqet proceset e ndërtimit të kapaciteteve të përfshira.




Figura1.Proceset e ndërtimit të kapaciteteve

Aktiviteti 4.2 nga Komponenti 4 nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të Bazuar në Rezultate (RRSMP) mbulon detyrat e mëposhtme:

- Detyra 4.2.1: Përgatitjedhe shpërndarje e programeve trajnuese që adresojnë parimet dhe praktikatat e një fushate efektive të publicitetit dhe ndërgjegjësimit
- Detyra 4.2.2: Trajnim gjatë punës për zbatimin e fushatës së publicitetit dhe ndërgjegjësimit

Ky dokument përmban rezultatet që lidhen me detyrën 4.2.2 për angazhimin e konsulentëve të jashtëm dhe ekspertëve ndërkombëtarë.

3. Metodologjia e trajnimit

Për shkak të përhapjes në mbarë botën të Corona virusit të ri, trajnimet që ishin të planifikuara për t'u zhvilluar në prezencë ukythen në formatin *online*.

Trajnimet u ndanë në tre seanca:

- ✓ Seanca 1: Kryerja e sondazheve përtë identifikuar sjelljet me rrezik të lartë të përdoruesve të rrugëve dhe vlerësimi i efijencës së fushatës së ndërgjegjësimit
- ✓ Seanca 2: Hartimi iFushatës së Publicitetit dhe Ndërgjegjësimit për Sigurinë Rrugore
- ✓ Seanca 3: Praktikatat më të mira nga vendet e tjera rreth fushatëvetë publicitetit dhe ndërgjegjësimit

Projekti mblodhi palëte interesuara që janë relevante dhe i përgatiti ata mbi hartimin and zbatimin e fushatëve vjetore të publicitetit dhe ndërgjegjësimit në korridore dhe zona me rrezikshmëri të lartë.

Në trajnimet mbi hartimin and zbatimin e fushatëve vjetoretë publicitetit dhe ndërgjegjësimit në korridore dhe zoname rrezikshmëri të lartë u përfshinë përfaqësuesit e organizmave të mëposhtëm që janë të lidhur me çështje të sigurisë rrugore në Shqipëri:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / Drejtoria e Transportit dhe Shërbimeve;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Ministria e Brendshme / Drejtoria për Autoritetet Vendore (përfshirë bashkitë relevante, si prsh: Bashkia e Tiranës);
- Policia Rrugore Shqiptare;
- Instituti i Transportit;
- Ministria e Arsimit;
- Shërbimi i Emergjencave në Shqipëri;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Gazetarë.

Është e rëndësishme që të gjithë palëte interesuara që veprojnë për sigurinë rrugore në Shqipëri të kenë një nivel të lartë të përgatitjes mbi problematikat e sigurisë rrugore. Materialet e trajnimeve u përgatiten bazuar mbi analizën e situatës kombëtare, nevojave të palëve të interesuara, rezultatet nga kërkimet sasore dhe cilësore dhe eksperiencës më të mirë ndërkombëtare.

4. Kryerja e sondazheve përtë identifikuar sjelljet me rrezik të lartë të përdoruesve të rrugëve dhe vlerësimi i efiçencës së fushatës së ndërgjegjësimit

Seancat e trajnimeve nën Komponentin 4 u filluan më 8 Mars me seancën e parë të trajnimit të lidhur me sondazhet, me titull “Kryerja e sondazheve përtë identifikuar sjelljet me rrezik të lartë të përdoruesve të rrugëve dhe vlerësimi i efiçencës së fushatës së ndërgjegjësimit”. Seanca e trajnimit filloi në orën 09:30. Trajnimi zgjati 2 orë e gjysëm (sipas ftesave të bashkëlidhura këtij Raporti) dhe të morën pjesë 39 pjesëmarrës.

Seanca e trajnimit përmbajti dy komponentë: një lidhje me sondazhet në përgjithësi dhe një tjetër referuar specifikës së vlerësimit të sondazheve.

Duke e ditur se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve nuk do të angazhohet nga fillimi deri në fund në kryerjen e sondazheve, qëllimi i seancës së trajnimit u fokusua që t’u jep të pjesëmarrësve njohuritë fillestare mbi:

- ✓ Si të lexojnë të dhënat e sondazheve – bazuar në kampionin e marrë për shembull, intervalin e konfidencës dhe margin e gabimit çfarë përfundimesh mund të nxirren mbi rezultatet e figurave,
- ✓ Si të analizojmë të dhënat – çfarë paketa analizash (software) mund të përdoren dhe çfarë mund të bëhet me ndihmën e resurseve analitike të mëtejshme, si prsh: MS Excel,
- ✓ Si të zgjedhim dizajnin e marrë për shembull and masën e kampionit,
- ✓ Si të zhvillojmë një pyetësor mbi sigurinë rrugore përtë identifikuar sjelljet e gabuara
- ✓ dhe, në fund, njohuria që duhet të kemi për të zhvilluar një sondazh me kërkesa të shkurtra, kur është e nevojshme.

Në komponentin e parë të seancave të trajnimit u dhanë informacionet mbi rëndësinë e sondazheve/konsultimet me komunitetin, elementet kryesore të sondazhit (si prsh: teknikat e dizenjimit, tipet dhe masat e kampionit të marrë për shembull dhe pyetëtori) dhe hapat e të gjithë procesit të kryerjes së një sondazhi. Në komponentin e dytë u prezantuan elementët më relevantë dhe më të veçantë të vlerësimit të sondazhit, duke ilustruar një shembull nga ushtrimi i vlerësimit pilot të kryer nën Komponentin 4 të Projektit.

Gjithashtu, duke marrë parasyshqënjë ndër qëllimet më kryesore ishte që të mundësohen pjesëmarrësit për të shkruar një sondazh me kërkesa të shkurtra, u dhanë informacione mbi buxhetin mesatar dhe kohëzgjatjen e kryerjes së një sondazhi.

Prezantimi i përdorur në seancën e trajnimit është e aneksuar në këtë raport.

5. Hartimi i Fushatës së Publicitetit dhe Ndërgjegjësimit për Sigurinë Rrugore

Seanca e dytë e trajnimit në lidhje me fushatën e publicitetit dhe ndërgjegjësimit nën Komponentin 4 u zhvillua më 11 Mars, me titull “Hartimi i Fushatës së Publicitetit dhe Ndërgjegjësimit për Sigurinë Rrugore”. Seanca e trajnimit filloi në orën 09:30. Ajo zgjati 3 orë dhe në trajnim morën pjesë 39 pjesëmarrës.

Seanca e trajnimit përfshiu komponentet e mëposhtme:

- ✓ Problemi botëror mbi sigurinë rrugore
- ✓ Natyra e faktorëve të rrezikut të sigurisë rrugore
- ✓ Figurat mbi sigurinë rrugore në Shqipëri
- ✓ Hartimi i fushatave të ndërgjegjësimit për sigurinë rrugore

Në fazën fillestare ishte e rëndësishme për të përkufizuar disa nga konceptet bazike. Trajnimi mundësoi një hyrje në lëmin e sigurisë rrugore, impaktit të shkaktuar nga dëmtimet dhe vdekjet, të dhënat botërore mbi mobilitetin, dhe planin botëror për të marrë masa ndaj përmirësimit të sigurisë, qëllimi mbi problematikat e sigurisë së rrugëve në mbarë botën dhe qasja e një objektivi botëror për të ulur vdekjet dhe dëmtimet nga trafiku rrugor me 50% deri më 2030.

Materialet e trajnimit i ndihmuan pjesëmarrësit që të kuptojnë faktorët elementarë të rrezikut (shpejtësia, vulnerabiliteti fizik dhe masa/mbrojtja) dhe faktorët që rrisin rrezikun (pirja dhe drejtimi i automjetit, shpejtësia, mos patja e eksperiencës, mos patja vëmendjes, etj.), rreziqet ose kanosjet me të cilat përballen shqiptarët dhenjë grup specifik i përdoruesve të rrugës.

Seancat patën si qëllim ndërtimin e kapaciteteve për të hartuar and zbatuar fushatat e publicitetit dhe ndërgjegjësimit për sigurinë rrugore. Pjesëmarrësit u trajnuan për të analizuar problematikat e sigurisë rrugore dhe se si të arrijnë të ndërmarrin zgjidhje efektive dhe efçente. Kjo përfshin edhe zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të ndërgjegjësimit mbi sigurinë rrugore të përshtatura me rrethanat vendore. Materialet e trajnimeve i ndihmuan pjesëmarrësit që të kuptojnë procesin e hartimit të fushatave mbi sigurinë rrugore, si të identifikojnë audiencën parësore dhe dytësore gjatë fazës së planifikimit, si të vendosen objektivat dhe qëllimet, si të përfshihen komuniteti, bizneset dhe sektori i OJQ-ve dhe palët e tjera të interesuara në fushatë, si të komunikohet me median dhe si të zbatohen fushata të bazuara në evidencë. Një fokus i veçantë iu dedikua instruktimit të përfituesve, të cilët zhvillojnë trajnime, mbi mënyrën se si të marrin maksimumin nga fushatat e publicitetit dhe të ndërgjegjësimit.

Prezantimi i përdorur në seancat e trajnimit është i aneksuar në këtë raport.

6. Praktikrat më të mira nga vendet e tjera rreth fushatave të publicitetit dhe ndërgjegjësimit

Seanca e tretë e trajnimit u krye më 19 Mars, me titull “Praktikat më të mira nga vendet e tjera rreth fushatave të publicitetit dhe ndërgjegjësimit”. Seanca e trajnimit filloi në orën 09:30. Ajo zgjati 3 orë dhenë trajnim morën pjesë 39 pjesëmarrës.

Në seancën e trajnimit uprezantuan:

- ✓ Mësimet e rëndësishme që mund të merren nga vlerësimi i fushatave
- ✓ Praktikrat më të miranga vendet e tjera
- ✓ Media si një palë e interesuar mbi Fushatat për Sigurinë Rrugore
- ✓ Qasja për një Sistem të Sigurtë për Sigurinë Rrugore
- ✓ Lista e Detyrave të Programit të Komunikimit të Fushatës
- ✓ Rasti studimor 1 –Promovimi i Rripit të Sigurimit
- ✓ Rasti studimor2 –Fushatat e Ndërgjegjësimit dhe e Edukimit mbi sigurinë rrugore në Korridorin E-60 të Tbilisi-Poti dhe në panelet në Korridorin përgjatë kësaj autostrade

Fokusi kryesor i seancës së tretë ishte prezantimi i praktikave më të mira nga vendet e tjera mbi fushatat publicitare dhe ndërgjegjësuere për sigurinë rrugore dhe përmirësimi i njohurive mbi faktorët themelorë që ndikojnë në sjelljen e përdoruesit të rrugës.

Trajnimi u dha pjesëmarrësve informacione për të organizuar dhe për të shprehur në mënyrë efektive njohuritë e përgjithshme mbi teorinë dhe praktikën e zhvillimit të fushatës së sigurisë rrugore. Në të u shqyrtuan metodat e publicitetit të sigurisë rrugore dhe zbatimit të fushatës së ndërgjegjësimit si dhe shembuj të rasteve të suksesshme në të gjithë botën.

U përshkruan pikat e forta dhe pikat e dobta të disa prej strategjive më të zakonshme të fushatës. Në aspektin e hartimit të fushatës së sigurisë rrugore, u identifikuan faktorët që mund të përmirësojnë efektivitetin e fushatës, të tillë si integrimi i reklamave me aktivitete të tjera (p.sh. forcimi), përshtatja e përmbajtjes së mesazhit dhe mjeteve të komunikimit me karakteristikat e audiencës së synuar dhe përdorimi i teknologjisë së re dhe formave të shumëfishta të mediave për të arritur audiencën e synuar. Gjithashtu, u shqyrtua në niveleve të ndryshme të ekspozimit të reklamave dhe u diskutuan efikasiteti i thirrjes së kërcënimit dhe alternativave të tjera (si prsh. thirrjet pozitive emocionale). Trajnimi u përqendrua në ato elementë të publicitetit të sigurisë rrugore që janë më efektive dhe për kë janë ato.

Në seancë u theksuan vështirësitë për krijimin e efektivitetit të një fushate publiciteti dhe ndërgjegjësimi, u shqyrtuan metodat e ndryshme të vlerësimit dhe u diskutua mbi vlerën e masave të ndryshme të vlerësimit të fushatës.

Gjithashtu, në seancën e trajnimeve pjesëmarrësve iu prezantua lista e detyrave të programit të komunikimit të fushatës për t'i ndihmuar ata që të përcaktojnë qartë dhe të menaxhojnë në mënyrë efektive procesin e zhvillimit dhe zbatimit të fushatës së publicitetit dhe ndërgjegjësimit të sigurisë rrugore.

Prezantimi i përdorur në sesionin e trajnimit është ngarkuar në faqen e internetit të projektit (www.roadsafety.al) dhe është bashkëlidhur këtij raporti.

Aneks A Slidet e trajnimit